



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:247056

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647649

KPPP.nr. 1864/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbareme të kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, rr. "UÇK", nr. 2, kundër debitorit "Dona Pharm" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810120725 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rexhep Potera, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr. 420/2023 të datës 17.08.2023, lëshuar nga Përmbaremi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Dona Pharm" Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbareme P.nr. 420/2023, i datës 17.08.2023, lëshuar nga Përmbaremi Privat Destan Bujupaj, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t'ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej EUR 156.00 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar urdhrin përmbareme P.nr. 420/2023, të datës 17.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. 201912751, e datës 20.12.2022, duke detyruar debitorin "Dona Pharm" Sh.P.K., që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin

në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 1,000.00 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përbarimor duke theksuar se kreditori ka pasur obligim që të dërgojë vërejtjen me shkrim se do të iniciojë procedurën përbarimore, ashtu që nuk i ka dhënë mundësi që të përmbushë detyrimin në mënyrë vullnetare, si dhe nuk ka prezantuar faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përbarimor por një faturë tjetër. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 156.00 €.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke shtuar se pretendimet e tilla nuk paraqesin bazë për kundërshtim sipas dispozitave të nenit 71 të LPP-së. Ka shtuar se dokumenti përbarues i nxjerrë në procedurë administrative/kundërvajtje në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së është bërë i përbarueshëm sipas rregullave me të cilat rregullohet kjo procedurë, konkretisht nenit 30.4 të Ligjit për Kundërvajtje. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Fatura nr. 201912751, e datës 20.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se fatura e lartcekur, nuk përmban

nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit se dokumenti mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor i plotëson kushtet për të qenë i përshtatshme për përmbartim, mirëpo gjeti se nga shkresat e lëndës faturës së bashkangjitura i mungon nënshkrimi i debitorit si dhe nuk ka ofruar prova se ka dorëzuar të njëjtën në njëërën nga mënyrat e dorëzimit, ashtu që nuk ka konfirmim të pranimit të faturës nga ana e debitorit, përkatësisht konfirmim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo faturë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbartimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të debitorit në emër të prapësimit të ushtruar, në vlerë prej EUR 156.00, konform rregullores për tarifa të OAK-së.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1864/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.